



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3605 Prot.

Roskovec, më 21.06 2019

VENDIM

NR 55 .DATË 19.06 /2019

“PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE TARIFËS PËR PAISJEN E OPERATORVE
TURISTIK ME LIBËR UDHËTIMI”**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, të Ligjit 93/2015 “Për Turizmin”, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, të Udhëzimit Nr.15, datë 24.07.2007 “Për Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të Udhëzimit nr.5627, data 18/11/ 2016, “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacioni për lëshimin e licensave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të Udhëzimit nr.5402/2, datë 24.11.2016 “Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik”, lidhur me kërkesat e operatorve turistik për pajisjen e tyre me Liber Udhëtimi, për të bërë të mundur funksionimin normal të aktivitetit të tyre, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Miratimin e formës dhe përmbajtjen e Librit të Udhëtimit për shërbimet turistike.
- Miratimin e tarifës 5000 lekë / çdo libër udhëtimi.

Shënim:

Libri i udhëtimit do të përmbaj faqen e parë (kopertinën), 25 faqe të brendëshme (që secila shërben për një udhëtim) dhe faqen e pasme (dispozitat).

Bashkëlidhur një format i Librit të Udhëtimit.

KRYETAR
Eleni Goga





BASHKIA ROSKOVEC

Lidhja 1
Faqja e pare
(Pjesa e përparme)

- Nr. i librit001.....

Shërbimet turistik/të rastit të udhëtarëve brenda vendit

LIBRI I UDHËTIMIT

Për shërbimet e turistike/të rastit në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit me autobus, në përputhje me:

Kreun II.2 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar dhe Udhëzimin nr.8885, datë 7.11.2016 "Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik".

Emri i transportuesit :

Adresa :

Numri i serisë së prodhimit të librit001.....







MAJLINDA BUFI

Firma dhe Vula
E Autoritetit Kompetent

DOKUMENTI I UDHËTIMIT PËR SHËRBIME TË RASTIT BRENDIA VENDIT

Nr. i Librit:.....

Nr. i Listës së udhëtarëve:

1	 Targa e autobusit	Numri i vendeve të udhëtarëve 
2	 Emri ose emri tregtar i operatorit të transportit
3	 Emri i drejtuesit ose drejtuesve të automjetit	1. 2. 3.
Lloji i shërbimit (vini një kryq në kutinë e duhur dhe shtoni informacionin plotësues)		
4	 Udhëtimi me dyer të mbyllura <input type="checkbox"/>	 Udhëtimi i vajtjes me ngarkesë <input type="checkbox"/> Udhëtimi i kthimit pa ngarkesë <input type="checkbox"/> * Vendi ku kanë zbritur udhëtarët

LISTA E UDHËTARËVE

NR	EMËR MBIEMËR	NR	EMËR MBIEMËR	NR	EMËR MBIEMËR
1		19		37	
2		20		38	
3		21		39	
4		22		40	
5		23		41	
6		24		42	
7		25		43	
8		26		44	
9		27		45	
10		28		46	
11		29		47	
12		30		48	
13		31		49	
14		32		50	
15		33		51	
16		34		52	
17		35		53	
18		36		54	

VENDI DHE DATA E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT		FIRMA/ VULA E OPERATORIT TË TRANSPORTIT	
AUTORITETI KONTROLLIT			

SHËNIME TË RËNDËSISHME

1. Libri i udhëtimit ju lëshohet vetëm subjekteve të licencuar për të tretë dhe me qira në transportin e udhëtarëve.
2. Libri i udhëtimit jep të drejtën e kryerjes së shërbimeve të rastit brenda vendit, që janë:
 - udhëtimet me dyer të mbyllura ku i njëjti autobus do të transportojë të njëjtin grup udhëtarësh përgjatë gjithë udhëtimit dhe do t'i sjellë përsëri në pikën nga ku u nisën.
 - shërbime që kryejnë udhëtimin në vajtje me ngarkesë dhe udhëtimin e kthimit pa ngarkesë. Pika e nisjes është në vendin ku është vendosur operatori i transportit.
 - shërbime gjatë të cilave udhëtimi në vajtje është kryer pa ngarkesë dhe gjithë udhëtarët të transportuar më parë nga i njëjti operator transporti kanë kryer udhëtimin e kthimit në pikën e nisjes.
3. Informacion rreth plotësimit të dokumentit të udhëtimit.
 - a) Për çdo udhëtim të kryer si një shërbim të rastit, operatori i transportit duhet të plotësojë një dokument udhëtimi në dy kopje, para nisjes së udhëtimit. Kopja e modelit të udhëtimit do të mbesë në ndërmarrje.
 - b) Fleta e parë e dokumentit të udhëtimit duhet të mbahet në autobus gjatë gjithë udhëtimit dhe do të paraqitet sa herë kërkohet nga organet e kontrollit.
 - c) Gjatë shërbimeve të rastit, asnjë udhëtar nuk mund të hipë ose të zbresë gjatë udhëtimit.
 - d) Transportuesi është i detyruar të sigurojë që dokumenti i udhëtimit është i plotësuar në mënyrën e duhur. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet me shkronja të mëdha shtypi dhe me bojë që nuk hiqet.
4. Libri i udhëtimit mban emrin e transportuesit dhe nuk është i transferueshëm.
5. Libri i udhëtimit përdoret për 25 udhëtime të shërbimeve të rastit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8606 Prot.

Roskovec, më 21.06 2019

VENDIM

NR 56 .DATË 19.06.2019

“PLAN STANDARD I VEPRIMIT DHE MONITORIMIT PËR MBLEDHJEN E TAKSËS SË NDËRTESESË DHE TARIFËS SË PASTRIMIT”

Në mbështetje të:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.Sh.-së” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Miratimin e Planit Standart të Veprimit dhe Monitorimit për mbledhjen e taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrimit.

Qëllimi i këtij plani veprimi dhe monitorimi paraqet hapat kryesorë që Bashkia duhet të ndërmarrë në procesin e mbledhjes së taksës së ndërtesës dhe tarifës pastrimit, duke identifikuar proceset që kryhen, afatet, sektorët përgjegjës për kryerjen dhe monitorimin, si dhe format dhe formatet e komunikimit me taksapaguesit. Qëllimi i hartimit të këtij plani veprimi është standardizimi i procedurave, bazuar mbi kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim përmirësimin e proceseve në Bashki dhe rritjen e vjeljes së taksës së ndërtesës dhe tarifës së Pastrimit.



Veprimet që ndërmerren për mbledhjen e taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrimit sipas këtij plan standarti janë:

- Vendosija e nivelit të taksës mbi ndërtesën dhe nënkategorive dhe përcaktimi i kostos së shërbimit për tarifën e pastrimit
- Aprovimi i *“Metodologjisë së komunikimit dhe ndërgjegjësimit* sigurimi i informacionit
- Përdorimi i Kadastrës Fiskale dhe verifikimi në terren i të dhënave pronësore dhe llogaritja e Tarifës së Pastrimit
- Përditësimi i të dhënave të Kadastrës Fiskale dhe miratimi i Tarifës së Pastrimit
- Identifikimi i taksapaguesve që përjashtohen
- Përpilimi i regjistrit të taksapaguesve
- Krijimi i bazës së të dhënave potenciale të taksapaguesve
- Përpilimi dhe printimi i *“Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë”*
- Dërgimi i *“Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë”*
- Pagesa e *“Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë”*
- Dërgimi i *“Letër kujtesës për pagesë”*
- Fillimi i procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimit
- Lëshimi i *“Urdhër për bllokimin e llogarive bankare”*.
- Marrja e masës së sigurimit të detyrimit, barrë siguruese dhe /ose hipotekore
- Njoftimi i vendosjes së barrës siguruese dhe /ose hipotekore tatimpaguesit
- Vendosija dhe njoftimi i *“Urdhërit të Sekuestrimit”*
- Krijimi i një programi që lehtëson llogaritjen dhe gjenerimin e taksës mbi ndërtesën dhe tarifës së pastrimit.

KRYETAR

Eleni Goga



PLANI STANDARD
I
VEPRIMIT DHE MONITORIMIT
PËR
MBLEDHJEN E TARIFËS SË PASTRIMIT

Hartuar nga *Drejtoria e Të Ardhurave Vendore*

Datë 12.06.2019

Aprovuar nga *Kryetari i Bashkisë*

Datë ___ .06.2019

Qëllimi

Ky plan veprimi dhe monitorimi paraqet hapat kryesorë që Bashkia duhet të ndërmarrë në procesin e mbledhjes së tarifës së pastrimit, duke identifikuar proceset që kryhen, afatet, sektorët përgjegjës për kryerjen dhe monitorimin, si dhe format dhe formatet e komunikimit me taksapaguesit. Qëllimi i hartimit të këtij plani veprimi është standardizimi i procedurave, bazuar mbi kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim përmirësimin e proceseve në Bashki dhe rritjen e vjeljes së tarifës së pastrimit.



PLANI STANDARD I VEPRIMIT
PËR MBLEDHJEN E TARIFËS SË PASTRIMIT

1. Baza ligjore

Ky plan veprimi është hartuar bazuar mbi:

- Ligjin nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.Sh.-së” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM vendim nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”;

2. Drejtoritë/Sektorët përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit

Përgjegjës për zbatimin e këtij plani veprimi janë:

- Drejtoria/ sektori i tatim taksave;
- Drejtoria/ sektori i financës;
- Drejtoria/ sektori juridik;
- Policia Bashkiake
- Ndërrmarrja e pastrimit, gjelberimit dhe mirembajtje varreza

3. Hapat që ndërmerren për mbledhjen e tarifës së pastrimit

3.1.Përcaktimi i kostos së shërbimit. Në mungesë të një metodologjie të aprovuar nga Bashkia, një alternativë jepet në VKM nr. 319 datë 31.05.2018 “Mbi miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, ku duhen marrë në konsideratë:

- a) të Dhënat e Përgjithshme të NJQV;
- b) investimet;
- c) shpenzimet Operative;
- ç) shpenzimet për trajtimin e Landfill-eve;
- d) shpenzimet e amortizimit (riinvestimi);
- dh) shpenzimet administrative;

3.2.Sigurimi i informacionit. Duhet marrë në konsideratë:

- a) numri i familjeve;
- b) numri i anëtarëve të secilës familje;
- c) sipërfaqja e pronës për çdo familje;
- ç) numri i bizneseve;
- d) sipërfaqja e pronës për çdo biznes;



- dh) kategoritë e biznesit dhe aktiviteti i tyre;
- e) numri i institucioneve;
- ë) numri i punonjësve / shfrytëzuesve të secilit institucion;
- f) adresa për çdo klient (familje, institucion, biznes);

3.3. Llogaritja e Tarifes së Pastrimit.

A. Bazuar në një sistem të përshtatshëm që i plotëson parimet:

- Kthimi i kostos;
- Ndotësi paguan;
- Barazia;
- Ekuivalenca;
- Transparenca;
- Thjeshtësia;

B. Bazuar në metodologjinë e miratuar nga Këshilli ose me VKM Nr.319, datë 31.05.2018 bazuar në faktorët e përcaktuar nga variablat si:

- Tipologjia e taksapaguesve
 - i. Familiare
 - ii. Institucione
 - iii. Biznese

Rezultati	Kategoria		
	1	2	3
I ulët	+20%	+40%	+20%
Mesatar	+20%	+60%	+20%
I Lartë	+60%	+80%	+20%

- Dimensionet
 - i. Nr i familiareve
 - ii. Nr i te punësuarve
 - iii. Sipërfaqja per m²
- Bazuar në oborret në përdorim
- Largësia

3.4. Miratimi i Tarifës së Pastrimit. Duhet të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak, duke marrë parasysh propozimin.

3.5. Aprovimi i "Metodologjisë së komunikimit dhe ndërgjegjësimit". Para datës 1 Janar të çdo viti, zyra e marrëdhënieve me publikun i propozon Këshillit Bashkiak "Metodologjinë e komunikimit dhe ndërgjegjësimit" të taksapaguesve. Këshilli miraton kanalet dhe format e komunikimit, për të sensibilizuar opinionin publik për rëndësinë e një procesi efektiv të mbledhjes së të ardhurave nga taksapaguesit vendorë, si për shembull:

- a) krijimi i një info-point;
- b) promovimi i incentivave;
- c) fushata informuese etj;



3.6 Aprovimi ose jo i një agjenti tatimor për mbledhjen e tarifës së pastrimit. Para datës 1 Janar të çdo viti, Këshilli Bashkiak ka të drejtën të aprovojë, me vendim, nëse do të përdoret agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së pastrimit. Në përzgjedhjen dhe përcaktimin e agjentit tatimor mund të merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- a) numri dhe specializimi i të punësuarve të agjentit;
- b) organizimi i strukturës të jetë sa më efektiv, për të mbuluar të gjitha proceset;
- c) sistemi i përdorur për llogaritjen dhe gjenerimin e detyrimit, ndarjen e zërave në detyrim, gjoha, norma interesi etj;
- ç) aftësinë për të krijuar një proces fleksibël, efektiv dhe efikas të punës;
- d) pagesën e agjentit;
- dh) të garantojë komunikimin e sistemit të Bashkisë me atë të agjentit, për shkëmbimin, azhurnimin, apo regjistrimin e të dhënave dhe pagesave në kohë reale;
- e) të respektojë procedurat e njoftimit dhe komunikimit me taksapaguesin siç parashikuar në ligjin për procedurat tatimore;
- ë) të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit mbi të dhënat;

3.7. Krijimi i bazës së të dhënave potenciale të taksapaguesve Marrja e të dhënave duke shkëmbyer informacion me institucionet e tjera qendrore ose lokale si:

- Zyra e Gjendjes Civile,
- Zyra e Planifikimit Urban në NJQV;
- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
- Regjistri i Gjendjes Civile;
- Konsumatorët e Ujësjetës dhe Kanalizimeve;
- Zyra e Taksave
- Drejtoria Arsimore

3.8. Identifikimi i taksapaguesve që përjashtohen. Bazuar në ligjin për taksat vendore apo ligje të tjera specifike, identifikohen dhe listohen të përjashtuarit nga pagesa e taksës së ndërtesës. Drejtoria e tatim taksave dhe sektori i ndihmës ekonomike, para datës 1 Janar të çdo viti, duhet ti propozojnë dhe paraqesin Këshillit Bashkiak kategoritë që mund dhe duhet të përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit. Lista e të përjashtuarve konform ligjit për taksat vendore gjendet bashkëlidhur në **Aneks 2**.

3.9. Përpilimi i regjistrit të taksapaguesve. Drejtoria e tatim taksave, në vijim të vendimit të Këshillit Bashkiak, duhet të pastrojë bazën e të dhënave nga taksapaguesit e përjashtuar, me qëllim identifikimin dhe evidentimin e taksapaguesve efektivë dhe krijimin e një liste të veçantë elektronike të taksapaguesve.

3.10. Përpilimi dhe printimi i "Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë". Kadastra Fiskale ose sistemi i NJQV-së përpilon dhe printon "Njoftim detyrimit dhe kërkesën për pagesë". Sistemi do të ishte më efektiv nëse lejon futjen në "Njoftimin e detyrimit dhe kërkesës për pagesë" jo vetëm të tarifës së pastrimit por edhe të taksave apo tarifave të tjera vendore.

3.11. Dërgimi i "Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë"¹. Brenda datës 10 Shkurt, Drejtoria e tatim taksave nis "Njoftim detyrimit dhe kërkesën për pagesë", sipas formatit bashkëlidhur në **Aneks 3**. Ka dy mënyra ligjore për të bërë njoftimin:

- a) në mënyrë elektronike, kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin në mënyrë elektronike;
- b) me postë rekomandë në adresën e saktë.

Kur njoftimet dërgohen me postë si më sipër, ato konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit me postë rekomandë.

Kërkesa për pagesë përmban elementet e përcaktuar në ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008:

¹ Përpara se të dërgohen njoftimet individuale, është e dobishme të bëhen njoftime publike, në kanale të ndryshme njoftimi, me skadencën e datës për pagesë.



- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) numrin e identifikimit;
- c) datën e njoftimit;
- ç) çështjen për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat që kanë të bëjnë me njoftimin;
- d) shumën e detyrimit;
- dh) kërkesën për pagesën e detyrimit dhe afatin e pagesës;
- e) vendin dhe mënyrën e pagesës së detyrimit;
- ë) shpjegimi i arsyes së detyrimit;
- f) shpjegimin e të drejtës së tatimpaguesit për të apeluar detyrimin.

3.12. Pagesa e "Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë", Pagesa e detyrimit mund të bëhet në:

- a) llogarinë bankare të Bashkisë; ose
- b) arkën e Bashkisë; ose
- c) me postë;

Nëse pagesa kryhet në arkën e Bashkisë, arkëtari i jep mandatin e arkëtimit taksapaguesit dhe regjistron pagesën në sistemin elektronik. Kur pagesa kryhet në bankë, shuma kalon në llogarinë e Bashkisë në thesar.

3.13. Rakordimi, Drejtoria e tatim taksave bëjnë rakordimet me agjentin dhe thesarin periodikisht, për të garantuar kalimin e pagesave në llogari të Bashkisë.

3.14. Dërgimi i "Letër kujtesës për pagesë", Nëse detyrimi nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në "Njoftimin e detyrimi dhe kërkesës për pagesë" dhe nuk është ankimuar brenda afatit ligjor², Bashkisë i lind e drejta të fillojë të zbatojë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit. Por, para se struktura e taksave në Bashki të fillojë procedurën e mbledhjes me forcë duhet të dërgojë debitorit një "Letër kujtesë për pagesë", sipas formatit bashkëlidhur në **Aneks 4**, "Letër kujtesa për pagesë" duhet të përmbajë të gjithë elementet e përmendur tek "Njoftim detyrimi dhe kërkesa për pagesë" dhe njoftohet po me të njëjtën mënyrë.

3.15. Fillimi i procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimit, Me skadimin e afatit të parashikuar në "Letër kujtesë për pagesë", Bashkia legjitimohet të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, të cilat mund të jenë:

- a) bllokim i llogarive bankare;
- b) barrë siguroese dhe /ose hipotekore;
- c) sekuestrim, konfiskim, dhe shitje në ankand.


3.16. Lëshimi i "Urdhër për bllokimin e llogarive bankare", Me një urdhër me shkrim të lëshuar nga Drejtori i tatim taksave, konform formatit bashkëlidhur në **Aneks 5**, u kërkohet bankave të nivelit të dytë bllokimi i një shume që duhet të jetë më e vogël midis:

- a) shumës që kërkohet të mbahet;
- b) shumës që rezulton në atë moment në llogarinë bankare të debitorit.

3.17.

3.18. Njoftimi i vendosjes së barrës siguroese dhe /ose hipotekore tatimpaguesit, Pas marrjes së vendimit për të vendosur një barrë siguroese dhe /ose hipotekore dhe para se kjo masë të shkojë për

² Aktualisht 30 ditë.



ekzekutim institucioneve të treta, tatimpaguesi duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi për barrën siguroese dhe /ose barrën hipotekore, konform formatit bashkëlidhur si **Aneks 6**, duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për:

- a) tatimpaguesin (identifikimi);
- b) detyrimin tatimor të papaguar;
- c) pasurinë, mbi të cilën është vendosur barrë siguroese dhe /ose hipotekore;
- d) fuqinë e administratës tatimore për të paraqitur kërkesë për ekzekutimin e masës së sigurimit.

Taksapaguesi, ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, qoftë në formën e barrës së sigurisë apo barrës hipotekore, në rastet kur pretendohet se zbatimi i tyre nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Komisionit të Apelit të Tatimor në Bashki.

3.19. Njoftimi i barrës siguroese dhe /ose hipotekore institucioneve përkatëse. Pasi tatimpaguesi është njoftuar për vendosjen e masës së sigurisë, kjo e fundit mund të njoftohet institucioneve të treta, duke respektuar kërkesat e VKM nr. 676, datë 15.10.2014, "Për përcaktimin e formatit dhe elementeve të njoftimit për barrën e sigurisë dhe /ose të hipotekës". Formatu gjendet bashkëlidhur si **Aneks 7**.


3.20. Vendosja dhe njoftimi i "Urdhrit të Sekuestrimit". "Urdhri i Sekuestrimit" është akti i vetëm me anë të të cilit administrata tatimore ka të drejtë të fillojë procedurat e sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes në ankand të pasurive kundrejt të cilave më parë ishte vendosur masa e sigurisë. "Urdhri i Sekuestrimit" bëhet me shkrim nga Drejtori i tatim taksave të Njesisë Vendore dhe duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a) emri i tatimpaguesit;
- b) NIPT-i, nr identifikimi;
- c) selia e regjistruar, adresa;
- ç) numri dhe data e njoftimit të vlerësimit tatimor;
- d) shumën e detyrimeve tatimore të papaguara;
- dh) afatin për pagesën e detyrimeve tatimore;
- e) pasurinë që sekuestron;
- ë) mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit;
- f) informacionin rreth së drejtës së tatimpaguesit për ankim administrativ

Urdhri i dërgohet tatimpaguesit, sipas formatit bashkëlidhur në **Aneks 8**, me postë rekomandë. Administrata mund ta sekuestrojë pasurinë vetëm 30 ditë kalendarike pas datës kur "Urdhri i sekuestrimit" është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

3.21. Krijimi i një programi që lehtëson llogaritjen dhe gjenerimin e tarifës pastrimit. Drejtorja e tatim taksave sipas mundësisë, krijojnë një program pune, i cili:

- a) të lejojë hedhjen, përpunimin dhe gjenerimin e të dhënave në mënyrë efektive dhe efikase;
- b) të jetë fleksibël për tu menaxhuar për lloje të ndryshme të taksave ose tarifave vendore;
- c) të jetë fleksibël në rastin e ndryshimit të metodologjisë për llogaritjen e taksave dhe tarifave;
- d) të ketë parametrat e sigurisë teknike për të garantuar ruajtjen, privatësinë, menaxhimin e të dhënave etj;
- e) të azhurnohet me të dhënat e plota të nevojshme për llogaritjen dhe gjenerimin e detyrimit;



Ky plan standart i veprimit dhe monitorimit per mbledhjen e takses se nderteses vlene per te gjitha tariat vendore.

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

P/Sektorit te Biznesit: D. Dhima

P/ Taksave dhe Tarifave Familjare: D. Goga



Kryetari i Bashkisë

Majlinda Buqi



Aneks 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

KËRKESË PËR PAGESËTË DETYRIMIT TATIMOR

(A) Numri Serial:

(B) Periudhatatimore

(C) NIPT/NSSH

(D) Emri i Tatimpaguesit

Arsyet për Kerkese Pagesë

Pagesë kundrejt detyrimittatimor

Detaje të kërkesë pagesës duke përfshirë kamatëvonesën dhe gjobën për pagesë të vonuar deri më:

Nxjerrë më _____ (Gjithsej per t'u paguar)

(Vlera e detyrimit është e vlefshme për datën e nxjerrjes së Kërkesës për pagesë. Për pagesa më vonë se kjo shumë mund të rritet me detyrime të tjera.

SHUMA E PAGUAR



Data, Vula e Bankes/Postes dhenenshkrimi i nepunesit te bankes/postes

Aneks 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë _____. _____. _____

Njoftim i vlerësimit të detyrimit tatimor

Për tatimpaguesin: (të dhënat si: emër, mbiemër, nr. identifikimi)

Me adresë: (adresa)

Sipas të dhënave që ne disponojmë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tatimeve, për periudhën (_____), rezulton se ju nuk keni paguar detyrimin si më poshtë vijon:

Nr	Taksa/Tatim	Periudha Tatimore	Detyrimipër t'upaguar	/Lekë	Arsyet e detyrimit (Tatim, Kamatëvonesë, Gjoha)
1	Taksa e ndërtesës		Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesë		
			Gjoha		
2			Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesë		
			Gjoha		
3			Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesë		
			Gjoha		
4			Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesë		
			Gjoha		

Nëse ju nuk paguani vlerën e plotë të detyrimit, brenda 30 ditëve nga marrja dijëni e këtij njoftimi, në llogarinë bankare të bashkisë _____ / apo arkën e Bashkisë / apo portalin e albania.net, jush do të fillojnë të zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, konform nenit 90 e në vijim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.



Për çdo sqarim që do t'iu duhet lidhur me këtë Njoftim vlerësimi të detyrimit tatimor si dhe kërkesës për pagesë bashkelidhur këtij njoftimi, mund të kontaktoni me Drejtorinë e Taksave dhe Tatimeve në Bashki.

Nëse keni kundërshtim për detyrimet, mund të bëni kërkesë për apelim në Komisionin e Apelit Tatimor në Bashki, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, konform ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kërkojmë të paguani të gjithë detyrimin e vlerësuar si më sipër, me formularët përkatës, në bankë apo **në postë**, në llogaritë e organit tatimor.

Kërkesës për apelim duhet t'i bashkëlidhni kopjet e dokumentave të pagesës së detyrimeve tatimore (tatim/kontribut) që lidhen me kërkesën (duke përjashtuar gjokat dhe kamatëvonesat); kopje të dokumentave përkatëse të dërguara nga Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve në Bashki si: njoftimi i vlerësimit për të gjitha llojet e detyrimeve, Kërkesa për Pagesë e detyrimit tatimor dhe çdo dokument tjetër që e vlerësoni të domosdoshëm për procesin e apelit.

Detyrim tatimor është ai i paraqitur në këtë tabelë (tatim/takse, kamatëvonesë, gjobë), sipas Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në RSH", neni 6.

Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



Aneks 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë ____ . ____ . ____

Letër kujtesë për pagesë

Për tatimpaguesin: (të dhënat si: emër, mbiemër, nr. identifikimi)

Me adresë: (adresa)

Sipas të dhënave që ne disponojmë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tatimeve, për periudhën (_____), rezulton se ju nuk keni paguar detyrimin si më poshtë vijon:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoba	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

Nëse ju nuk paguani vlerën e plotë të detyrimit, brenda 10 ditësh nga marrja dijëni e këtij njoftimi, në llogarinë bankare të bashkisë _____ / apo arkën e Bashkisë / apo portalin e-albania, ndaj jush do të fillojnë të zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, konform nenit 90 e në vijim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim që do t'iu duhet lidhur me këtë Letër kujtesë për pagesë, mund të kontaktoni me Drejtorinë e Taksave dhe Tatimeve në Bashki



Aneks 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Nr. Prot. _____

Datë _____

Lënda: Njoftim i urdhërit për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesit (të dhënat si: emër mbiemër, atësi, numër identifikimi, adresë)

Drejtuar: Bankave të nivelit të dytë (specifiko)

Për: dijeni: Tatimpaguesit (të dhënat)

1. Regjistrat tanë tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoba	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

2. Tatimpaguesit i është dërguar Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë. Letër kujtesë për pagesë, por këto detyrime nuk janë paguar ende.
3. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese, në përputhje me legjislacionin tatimor. Mbështetur në nenin 90 e vijues, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve ka vendosur Urdhër Bllokimi të llogarive bankare të tatimpaguesit të sipërcituar, për shumën e mësipërme të detyrimit.
4. Për këtë, kërkohet nga ana juaj bllokimi i një shumë që duhet të jetë më e vogël midis:
- shumës që kërkohet të mbahet;
 - shumës që rezulton në llogarinë bankare të debitorit.

Drejtorja e Taksave dhe Tatimeve nëpërmjet kësaj mase synon që, nga institucioni juaj të mos lejohen kryerje veprimesh nga tatimpaguesi deri në shlyerjen e plotë të detyrimit ndaj Bashkisë.



Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë

Aneks 6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë _____._____

Lënda: Njoftim për vendosjen e masë së sigurimit të detyrimit (specifiko nëse barrë siguruese dhe /ose hipotekore)

Drejtuar: Tatimpaguesit (emër, mbiemër, nr. identifikimi, adresë)

1. Regjistrat tanë tregojnë se ju nuk keni paguar, në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoha	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

2. Tatimpaguesit i është dërguar Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë, Letër kujtesë për pagesë, por këto detyrime nuk janë paguar ende.
3. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese, në përputhje me legjislacionin tatimor. Mbështetur në nenin 90 e vijues, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve ka vendosur masën e sigurimit të detyrimit (specifiko _____), mbi pasuritë e tatimpaguesit: (specifiko _____).
4. Mbas këtij njoftimi, bazuar në ligjin për procedurat tatimore, bashkia do të njoftojë institucionet përkatëse me qëllim vendosjen e masës së sigurimit mbi pasurinë tuaj dhe të drejtave reale mbi to, me qëllim shlyerjen e plotë të detyrimit ndaj Bashkisë.

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



Aneks 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë _____

NJOFTIM I PËRGJITHSHËM
PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE DHE HIPOTEKORE

Nga Bashkia _____, Njoftim për publikun e interesuar

1. Mbështetur në nenin 90 e vijues të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Bashkia _____ ka vendosur masën e sigurisë barrë hipotekore mbi pasurinë e subjektit:

Subjekti: _____

NIPT: _____


Adresa: _____

2. Regjistrat tanë tregojnë se ju nuk keni paguar, në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoha	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

3. Subjektit të sipërcituar i është dërguar dokumenti "Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë", për ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës.

4. Ky dokument përfaqëson barrën siguroese dhe hipotekore në favor të Bashkia _____, mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat ipërkasin këtij subjekti, lidhur me shumën e _____



detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (detyrimi, gjoja dhe kamatëvonesë). Vendosja e kësaj barre hipotekore/siguruese synon të garantojë pagiminë tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Ky dokument synon të njoftojë të gjitha palët që kanë interesa me këtë subjekt.

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë

Aneks 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Urdhër sekuestrimi ekzekutiv

Drejtuar: Institucionit / Tjetër (psh punëdhënsi, nëse sekuestrohet paga) _____

Adresa: _____

Për dëjneni: Tatimpaguesit (emër dhe mbiemër, NIPT/nr. identifikimi, selia/adresa)

1. Regjistrat tanë tregojnë se tatimpaguesi nuk ka paguar, në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoja	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

2. Tatimpaguesit i është dërguar Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë, Nr. ____, datë ____, por këto detyrime nuk janë paguar ende.
3. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese, në përputhje me legjislacionin tatimor. Mbështetur në nenin 90 e vijues, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve ka vendosur masën e sigurimit të detyrimit (specifiko _____), mbi pasuritë e tatimpaguesit: (specifiko _____).
4. Mbështetur në të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme/të luajtshme, apo të ardhura të tjera që disponon (institucioni) _____, si më poshtë:

Nr.	Lloji i Pasurisë	Vendndodhja e pasurisë
1.		
2.		



--	--	--

Nr.	Lloji i të ardhurës	Vendndodhja
1.		
2.		

Në bazë të këtij Urdhëri, bazuar në ligjin për procedurat tatimore, Bashkia urdhëron sekuestron e pasurinë (specifiko _____), me qëllim shlyerjen e plotë të detyrimit ndaj Bashkisë.

5. Nëse keni kundërshtime, në lidhje me këtë titull ekzekutiv, mund të bëni ankesë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të rrethit, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, konform gërmës d), neni 94 të ligjit "Për procedurat tatimore nr. 9920 datë 19.05.2008", i ndryshuar.

Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



PLANI STANDARD
I
VEPRIMIT DHE MONITORIMIT
PËR
MBLEDHJEN E TAKSËS SË NDËRTESESË

Hartuar nga *Drejtoria e Të Ardhurave Vendore*

Datë *2.06.2019*

Aprovuar nga *Kryetari i Bashkisë*

Datë *__06.2019*

Qëllimi

Ky plan veprimi dhe monitorimi paraqet hapat kryesorë që Bashkia duhet të ndër marrë në procesin e mbledhjes së taksës së ndërtesës, duke identifikuar proceset që kryhen, afatet, sektorët përgjegjës për kryerjen dhe monitorimin, si dhe format dhe formatet e komunikimit me taksapaguesit. Qëllimi i hartimit të këtij plani veprimi është standardizimi i procedurave, bazuar mbi kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim përmirësimin e proceseve në Bashki dhe tritjen e vjeljes së taksës së ndërtesës.



**PLANI STANDARD I VEPRIMIT
PËR MBLEDHJEN E TAKSËS SË NDËRTESESË**

1. Baza ligjore

Ky plan veprimi është hartuar bazuar mbi:

- Ligjin nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.Sh.-së” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të

pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

2. Drejtoritë/Sektorët përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit

Përgjegjës për zbatimin e këtij plani veprimi janë:

- Drejtoria/ sektori i tatim taksave;
- Drejtoria/ sektori i financës;
- Drejtoria/ sektori juridik;
- Policia Bashkiake

3. Veprimet që ndërmerren për mbledhjen e taksës së ndërtesës

3.1. Vendosja e nivelit të taksës mbi ndërtesën dhe nënkategorive. Para datës 1 Janar të çdo viti, Këshilli Bashkiak vendos mbi nivelin e taksës së ndërtesës, +-30% të bazës së taksës të përcaktuar në Ligjin për taksat vendore, si dhe ka të drejtën të bëjë kategorizime më të hollësishme, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, duke marrë parasysh komentet dhe sugjerimet e sektorëve të ndryshëm të Bashkisë.

3.2. Aprovimi ose jo i një agjenti tatimor për mbledhjen e tarifës së pastrimit. Para datës 1 Janar të çdo viti, Këshilli Bashkiak ka të drejtën të aprovojë, me vendim, nëse do të përdoret agjent tatimor për mbledhjen e taksës së ndërtesës. Në përzgjedhjen dhe përcaktimin e agjentit tatimor mund të merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- a) numri dhe specializimi i të punësuarve të agjentit;
- b) organizimi i strukturës të jetë sa më efektiv, për të mbuluar të gjitha proceset;
- c) sistemi i përdorur për llogaritjen dhe gjenerimin e detyrimit, ndarjen e zërave në detyrim, gjoba, norma interesi etj;
- ç) aftësinë për të krijuar një proces fleksibël, efektiv dhe efikas të punës;
- d) pagesën e agjentit;
- dh) të garantojë komunikimin e sistemit të Bashkisë me atë të agjentit, për shkëmbimin, azhurnimin, apo regjistrimin e të dhënave dhe pagesave në kohë reale;



e) të respektojë procedurat e njoftimit dhe komunikimit me taksapaguesin siç parashikuar në ligjin për procedurat tatimore;

ë) të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit mbi të dhënat;

3.3. Aprovimi i “Metodologjisë së komunikimit dhe ndërgjegjësimit”. Para datës 1 Janar të çdo viti, zyra e marrëdhënieve me publikun i propozon Këshillit Bashkiak “Metodologjinë e komunikimit dhe ndërgjegjësimit” të taksapaguesve. Këshilli miraton kanalet dhe format e komunikimit, për të sensibilizuar opinionin publik për rëndësinë e një procesi efektiv të mbledhjes së të ardhurave nga taksapaguesit vendorë, si për shembull:

a) krijimi i një info-point;

b) promovimi i incentivave;

c) fushata informuese etj;

3.4. Përdorimi i Kadastrës Fiskale dhe verifikimi në terren i të dhënave pronësore. Drejtoria e tatim taksave do të përdorë Kadastrën Fiskale, duke marrë parasysh caktimin e -- personave përgjegjës për përdorimin e saj, mundësisht të trajnuar për përdorimin e Kadastrës Fiskale. Kryetari i Bashkisë, me anë të një Urdhri, cakton një grup pune për të verifikuar në terren të dhënat specifike të Kadastrës Fiskale, duke marrë parasysh të gjithë elementet e nevojshme si zona,

sipërfaqja, katet, pronarët dhe /ose përdoruesit, të listuar në VKM nr. 132/2018. Format i për tu përdorur për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave të pasurisë gjendet bashkëlidhur në **Aneks 1**.

3.5. Përditësimi i të dhënave të Kadastrës Fiskale. Pas verifikimit të të dhënave në terren, përditësohet çdo pasuri e Kadastrës Fiskale me të gjithë elementët e kërkuara në VKM nr. 132/2018, duke pasur parasysh integrimin dhe përditësimin e të dhënave nëpërmjet komunikimit me institucionet e tjera qendrorë ose vendore si: Zyrën e Gjendjes Civile, Postën Shqiptare, Zyrën Rajonale Tatimore, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, OSHE, Ujësjetësin etj, në mënyrë periodike.

3.6. Identifikimi i taksapaguesve që përjashtohen. Bazuar në ligjin për taksat vendore apo ligje të tjera specifike, identifikohen dhe listohen të përjashtuarit nga pagesa e taksës së ndërtesës. Drejtoria e tatim taksave dhe /ose Drejtoria e ndihmës ekonomike, para datës 1 Janar të çdo viti, duhet ti propozojnë dhe paraqesin Këshillit Bashkiak kategoritë që mund dhe duhet të përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës. Lista e të përjashtuarve konform ligjit për taksat vendore gjendet bashkëlidhur në **Aneks 2**.

3.7. Përpilimi i regjistrit të taksapaguesve. Drejtoria e tatim taksave, në vijim të vendimit të Këshillit Bashkiak, duhet të pastrojë bazën e të dhënave nga taksapaguesit e përjashtuar, me qëllim identifikimin dhe evidentimin e taksapaguesve efektivë dhe krijimin e një liste të veçantë elektronike të taksapaguesve.

3.8. Përpilimi dhe printimi i “Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë”. Kadastra Fiskale ose sistemi i NJQV-së përpilon dhe printon “Njoftim detyrimit dhe kërkesën për pagesë”. Sistemi do të ishte më efektiv nëse lejon futjen në “Njoftimin e detyrimit dhe kërkesës për pagesë” jo vetëm të taksës së ndërtesës por edhe të taksave apo tarifave të tjera vendore.

3.9. Dërgimi i “Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë”¹. Brenda datës 20 Prill, Drejtoria e tatim taksave nis “Njoftim detyrimit dhe kërkesën për pagesë”, sipas formatit bashkëlidhur në **Aneks 3**. Ka dy mënyra ligjore për të bërë njoftimin:

a) në mënyrë elektronike, kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin në mënyrë elektronike;

¹ Përpara se të dërgohen njoftimet individuale, është e dobishme të bëhen njoftime publike, në kanale të ndryshme njoftimi, me skadencën e datës për pagesë.



b) me postë rekomande² në adresën e saktë³.

Kur njoftimet dërgohen me postë si më sipër, ato konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendrike pas datës së dërgimit me postë rekomande.

Kërkesa për pagesë përmban elementet e përcaktuar në ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) numrin e identifikimit;
- c) datën e njoftimit;
- ç) çështjen për të cilën bëhet njoftimi dhe periudhën ose periudhat që kanë të bëjnë me njoftimin;
- d) shumën e detyrimit;
- dh) kërkesën për pagesën e detyrimit dhe afatin e pagesës;
- e) vendin dhe mënyrën e pagesës së detyrimit;
- ë) shpjegimi i arsyes së detyrimit;
- f) shpjegimin e të drejtës së tatimpaguesit për të apeluar detyrimin.

3.10. Pagesa e "Njoftim detyrimit dhe kërkeses për pagesë". Pagesa e detyrimit mund të bëhet në:

- a) llogarinë bankare të Bashkisë; ose
- b) arkën e Bashkisë; ose
- c) me postë;

Nëse pagesa kryhet në arkën e Bashkisë, arkëtari i jep mandatin e arkëtimit taksapaguesit dhe regjistron pagesën në sistemin elektronik. Kur pagesa kryhet në bankë, shuma kalon në llogarinë e Bashkisë në thesar.

3.11. Rakordimi. Drejtoria e tatim taksave dhe /ose e financës bëjnë rakordimet me agjentin dhe thesarin periodikisht, për të garantuar kalimin e pagesave në llogari të Bashkisë.

3.12. Dërgimi i "Letër kujtesës për pagesë". Nëse detyrimi nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në "Njoftimin e detyrimi dhe kërkeses për pagesë" dhe nuk është ankimuar brenda afatit ligjor⁴. Bashkisë i lind e drejta të fillojë të zbatojë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit. Por, para se struktura e taksave në Bashki të fillojë procedurën e mbledhjes me forcë duhet ti dërgojë debitorit një "Letër kujtesë për pagesë", sipas formatit bashkëlidhur në **Aneks 4**. "Letër kujtesa për pagesë" duhet të përmbajë të gjithë elementet e përmendur tek "Njoftim detyrimi dhe kërkesa për pagesë" dhe njoftohet po me të njëjtën mënyrë.

3.13. Fillimi i procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimit. Me skadimin e afatit të parashikuar në "Letër kujtesë për pagesë", Bashkia legjitimohet të fillojë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, të cilat mund të jenë:

² Bashkia do të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me Postën Shqiptare për identifikimin e adresave dhe /ose për uljejn e tarifave të shërbimeve postare, në varësi të nr. të njoftimeve.

³ Bashkia do të punojë për të siguruar adresat e sakta të individëve si nga institucionet e treta si Gjendje Civile, Posta Shqiptare etj. ashtu edhe nëpërmjet vetëdeklarimeve nga individët kur ata paraqiten në Bashki për të marrë shërbime të tjera.

⁴ Aktualisht 30 ditë.



- a) bllokim i llogarive bankare;
- b) barrë siguruese dhe /ose hipotekore;
- c) sekuestrim, konfiskim, dhe shitje në ankand.

3.14. Lëshimi i “Urdhër për bllokimin e llogarive bankare”. Me një urdhër me shkrim të lëshuar nga Drejtori i tatim taksave, konform formatit bashkëlidhur në **Aneks 5**, u kërkohet bankave të nivelit të dytë bllokimi i një shume që duhet të jetë më e vogël midis:

- a) shumës që kërkohet të mbahet;
- b) shumës që rezulton në atë moment në llogarinë bankare të debitorit.

3.15. Marrja e masës së sigurimit të detyrimit, barrë siguruese dhe /ose hipotekore. Nëse debitori nuk ka paguar në datën e caktuar, detyrimi i papaguar shtrihet mbi të gjitha pasuritë e tij, në masën e duhur për të përmbushur detyrimin tatimor të tij në favor të administratës. Masa e sigurimit mund të jetë, sipas rastit, një barrë siguruese dhe /ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe /ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga kreu i strukturës së tatim taksave vendore .

3.16. Njoftimi i vendosjes së barrës siguruese dhe /ose hipotekore tatimpaguesit. Pas marrjes së vendimit për të vendosur një barrë siguruese dhe /ose hipotekore dhe para se kjo masë tu shkojë për ekzekutim institucioneve të treta, tatimpaguesi duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi për barrën siguruese dhe /ose barrën hipotekore, konform formatit bashkëlidhur si **Aneks 6**, duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për:

- a) tatimpaguesin (identifikimi);
- b) detyrimin tatimor të papaguar;
- c) pasurinë, mbi të cilën është vendosur barrë siguruese dhe /ose hipotekore;
- d) fuqinë e administratës tatimore për të paraqitur kërkesë për ekzekutimin e masës së sigurimit.

Taksapaguesi, ndaj pasurisë së të cilit ka dalë një vendim për vendosjen e masave të sigurisë, qoftë në formën e barrës së sigurisë apo barrës hipotekore, në rastet kur pretendohet se zbatimi i tyre nuk është ekzekutuar në mënyrë të rregullt, ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Komisionit të Apelit Tatimor në Bashki.

3.17. Njoftimi i barrës siguruese dhe /ose hipotekore institucioneve përkatëse. Pasi tatimpaguesi është njoftuar për vendosjen e masës së sigurisë, kjo e fundit mund tu njoftohet institucioneve të treta, duke respektuar kërkesat e VKM nr. 676, datë 15.10.2014, “Për përcaktimin e formatit dhe elementeve të njoftimit për barrën e sigurisë dhe / ose të hipotekës”. Formatit gjendet bashkëlidhur si **Aneks 7**.

3.18. Vendosja dhe njoftimi i “Urdhrit të Sekuestrimit”. “Urdhri i Sekuestrimit” është akti i vetëm me anë të të cilit administrata tatimore ka të drejtë të fillojë procedurat e sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes në ankand të pasurive kundrejt të cilave më parë ishte vendosur masa e sigurisë. “Urdhri i Sekuestrimit” bëhet me shkrim nga Drejtori i tatim taksave të Njësisë Vendore dhe duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a) emri i tatimpaguesit;
- b) NIPT-i, nr identifikimi;



- c) selia e regjistruar, adresa;
- ç) numri dhe data e njoftimit të vlerësimit tatimor;
- d) shumën e detyrimeve tatimore të papaguara;
- dh) afatin për pagesën e detyrimeve tatimore;
- e) pasurinë që sekuestrohet;
- ë) mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit;
- f) informacionin rreth së drejtës së tatimpaguesit për ankim administrativ

Urdhri i dërgohet tatimpaguesit, sipas formatit bashkëlidhur në **Aneks 8**, me postë rekomande. Administrata mund ta sekuestrojë pasurinë vetëm 30 ditë kalendarike pas datës kur “*Urdhri i sekuestrimit*” është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

3.19. Krijimi i një programi që lehtëson llogaritjen dhe gjenerimin e taksës mbi ndërtesën. Drejtoria e tatim taksave sipas mundësisë, krijojnë një sistem apo program pune, i cili:

- a) të lejojë hedhjen, përpunimin dhe gjenerimin e të dhënave në mënyrë efektive dhe efikase;
- b) të jetë fleksibël për tu menaxhuar për lloje të ndryshme të taksave ose tarifave vendore;
- c) të jetë fleksibël në rastin e ndryshimit të metodologjisë për llogaritjen e taksave dhe tarifave;
- d) të ketë parametrat e sigurisë teknike për të garantuar ruajtjen, privatësinë, menaxhimin e të dhënave etj;
- e) të azhurnohet me të dhënat e plota të nevojshme për llogaritjen dhe gjenerimin e detyrimit;

Ky plan standart i veprimit dhe monitorimit për mbledhjen e taksës së ndërtesës vlenë për të gjitha taksat vendore.

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

P/Sektorit të Biznesit: D. Dhima

P/ Taksave dhe Tarifave Familjare: D. Goga



**Kryetari i Bashkisë
Majlinda Bafi**



Bashkia _____

Nj. Admin _____

Nr/ _____ / Data/ / / _____

I. Te dhënat nga Sistemi i Kadastrës Fiskale

Numeri unik _____ Praga _____

Numeri i objektit _____ Hyrja _____ Ap-Dera _____ Kati _____

II. Te dhënat e Pasurisë

**Në rastin e mungesës së certifikatës së pronësisë të shënohet numri i dokumentit të ALUTENIT*

Certifikatë pronësie Po Jo Nr. _____

Zona Kadastrale _____ Adresa e Pasurisë _____

III. Objekti dhe njësia pronësore

Pronësi Individuale Pronësi Kolektive Pronë Publike Viti i ndërtimit _____

Sip. e ndërtimit (gjuha) _____ m² Sipërfaqja e truallit _____ m² Numri i kateve _____

Kati i njësisë pronësore _____ m² Nr objektit _____ Hyrja _____ Ap-Dera _____

IV. Subjekti deklarues i lidhur me pasurinë

Në pronësi Bashkëpronësi Me qira Në përdorim Tjetër

Familje _____ Individ NID _____

Biznes _____ Subjekt NIPT _____

Emër, Atësin, Mbiemër/Emri Aktivitetit _____

V. Në rast se deklaruesi nuk është pronar i njësive pronësore, të dhënat e pronarit

**Në rastin e bashkëpronësisë së plotësohen të dhënat për bashkëpronarët në panelin " Specifikime të para"*

Pronari/Poseduesi në rast se pasuria është e palegalizuar

NID _____ NIPT _____

VI. Statusi i pasurisë

Regjistruar Në legalim Kontratë Sht-Blerje Kontratë Sipërmanje

Ndërtimi pajisur me leje ndërtimi por i papërfunduar sipas afatit

Regjistruar dhe shtesa në legalim (përcakto sip. e regj. dhe shtesës) → Regjistruar _____ m²

→ Shtesa legalim _____ m²

VII. Sipërfaqja sipas kategorisë dhe qëllimit të përdorimit

Për familje	Për aktivitet ekonomik
Banor _____ m ²	Bujësi dhe Blegtori _____ m ²
Parkim i Mbuksuar _____ m ²	Tregtim dhe Shërbime _____ m ²
Bodrum _____ m ²	Vepimtarit Industriale _____ m ²
Parkim i Hapur _____ m ²	Parkim i Mbuksuar _____ m ²
Tjetër _____ m ²	Parkim i Hapur _____ m ²

VIII. Furnizimi me Energji Elektrike

Kodi i Klientit _____

Mbajtësi i kontratës/Emër, Atësin, Mbiemër _____

NID _____ NIPT _____

Familje _____ Biznes _____

IX. Furnizimi me Ujë

Kodi i Klientit _____

Mbajtësi i kontratës/Emër, Atësin, Mbiemër _____

NID _____ NIPT _____

Familje _____ Biznes _____



Aneks 2⁵

1. pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3. ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira tëpaliberalizuara;
4. banesat sociale në pronësi të bashkive;
5. pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
6. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7. strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
8. ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhetvetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë tëpaafitë për punë;
9. ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
10. ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, përkohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi përmonumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëmpër qëllime jofitimprurëse

⁵ Kjo listë përcakton vetëm përjashtimet konform ligjit për taksat vendore, dhe duhet të pasurohet me kategori që mund të parashikohen në ligje të tjera apo vendime të këshillit bashkiak.



Aneks 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

KËRKESË PËR PAGESËTË DETYRIMIT TATIMOR

(A) Numri Serial:

(B) Periudhatatimore

(C) NIPT/NSSH

(D) Emri i Tatimpaguesit

Arsyet për Kerkese Pagesë

Pagesë kundrejt detyrimittatimor

Detaje të kërkesë pagesës duke përfshirë kamatëvonesën dhe gjobën për pagesë të vonuar deri më:

Nxjerrë më _____ (Gjithsej per t'u paguar)

(Vlera e detyrimit është e vlefshme për datën e nxjerrjes së Kërkesës për pagesë. Për pagesa më vonë se kjo shumë mund të rritet me detyrime të tjera.

SHUMA E PAGUAR

Data, Vula e Bankes/Postes dheneshkrimi i nepunesit te bankes/postes



Aneks 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë ____ . ____ . ____

Njoftim i vlerësimit të detyrimit tatimor

Për tatimpaguesin: (të dhënat si: emër, mbiemër, nr. identifikimi)

Me adresë: (adresa)

Sipas të dhënave që ne disponojmë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tatimeve, për periudhën (____), rezulton se ju nuk keni paguar detyrimin si më poshtë vijon:

Nr	Takse/Tatim	Periudha Tatimore	Detyrim për t'upaguar	/Lekë	Arsyet e detyrimit (Tatim, Kamatëvonesa, Gjoha)
1	Taksa e ndërtesës		Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesa		
			Gjoha		
2			Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesa		
			Gjoha		
3			Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesa		
			Gjoha		
4			Taksa/Tatimi		
			Kamatëvonesa		
			Gjoha		

Nëse ju nuk paguani vlerën e plotë të detyrimit, brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij njoftimi, në llogarinë bankare të bashkisë _____ / apo arkën e Bashkisë / apo portalin e-albania, ndaj jush do të fillojnë të zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, konform nenit 90 e në vijim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.



Për çdo sqarim që do t'iu duhet lidhur me këtë Njoftim vlerësimi të detyrimit tatimor si dhe kërkesës për pagesë bashkëlidhur këtij njoftimi, mund të kontaktoni me Drejtorinë e Taksave dhe Tatimeve në Bashki.

Nëse keni kundërshtim për detyrimet, mund të bëni kërkesë për apelim në Komisionin e Apelit Tatimor në Bashki, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, konform ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kërkojmë të paguani të gjithë detyrimin e vlerësuar si më sipër, me formularët përkatës, në bankë apo **në postë**, në llogaritë e organit tatimor.

Kërkesës për apelim duhet t'i bashkëlidhni kopjet e dokumentave të pagesës së detyrimeve tatimore (tatim/kontribut) që lidhen me kërkesën (duke përfshirë gjërat dhe kamatëvonesat); kopje të dokumentave përkatës të dërguara nga Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve në Bashki si: njoftimi i vlerësimit për të gjitha llojet e detyrimeve, Kërkesa për Pagesë e detyrimit tatimor dhe çdo dokument tjetër që e vlerësoni të domosdoshëm për procesin e apelit.

Detyrim tatimor është ai i paraqitur në këtë tabelë (tatim/takse, kamatëvonesë, gjëbë), sipas Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008. "Për Procedurat tatimore në RSH", neni 6.

Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



Aneks 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë ____ . ____ . ____

Letër kujtesë për pagesë

Për tatimpaguesin: (të dhënat si: emër, mbiemër, nr. identifikimi)

Me adresë: (adresa)

Sipas të dhënave që ne disponojmë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tatimeve, për periudhën (____), rezulton se ju nuk keni paguar detyrimin si më poshtë vijon:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoha	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

Nëse ju nuk paguani vlerën e plotë të detyrimit, brenda 10 ditësh nga marrja dijeni e këtij njoftimi, në llogarinë bankare të bashkisë _____ / apo arkën e Bashkisë / apo portalin e-albania, ndaj jush do të fillojnë të zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit, konform nenit 90 e në vijim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008” Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për çdo sqarim që do t’iu duhet lidhur me këtë Letër kujtesë për pagesë, mund të kontaktoni me Drejtorinë e Taksave dhe Tatimeve në Bashki

Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TATIMEVE

Nr. Prot. _____

Datë _____

Lënda: Njoftim i urdhërit për bllokimin e llogarive bankare të tatimpaguesit (të dhënat si emër mbiemër, atësi, numër identifikimi, adresë)

Drejtuar: Bankave të nivelit të dytë (specifiko)

Për dijeni: Tatimpaguesit (të dhënat)

1. Regjistrat tanë tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kërkuar ligjor detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoha	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

2. Tatimpaguesit i është dërguar Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë. Letër kujtesë për pagesë, por këto detyrime nuk janë paguar ende.
3. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese, në përputhje me legjislacionin tatimor. Mbështetur në nenin 90 e vijues, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve ka vendosur Urdhër Bllokimi të llogarive bankare të tatimpaguesit të sipërcituar, për shumën e mësipërme të detyrimit.
4. Për këtë, kërkohet nga ana juaj bllokimi i një shumë që duhet të jetë më e vogël midis:
- shumës që kërkohet të mbahet;
 - shumës që rezulton në llogarinë bankare të debitorit.

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve nëpërmjet kësaj mase synon që, nga institucioni juaj të mos lejohen kryerje veprimesh nga tatimpaguesi deri në shlyerjen e plotë të detyrimit ndaj Bashkisë.

Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë ____ . ____ . ____

Lënda: Njoftim për vendosjen e masë së sigurimit të detyrimit (specifiko nëse barrë siguruese dhe /ose hipotekore)

Drejtuar: Tatimpaguesit (emër, mbiemër, nr. identifikimi, adresë)

1. Regjistrat tanë tregojnë se ju nuk keni paguar, në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoha	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

2. Tatimpaguesit i është dërguar Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë. Letër kujtesë për pagesë, por këto detyrime nuk janë paguar ende.
3. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese, në përputhje me legjislacionin tatimor. Mbështetur në nenin 90 e vijues, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve ka vendosur masën e sigurimit të detyrimit (specifiko _____), mbi pasuritë e tatimpaguesit: (specifiko _____).
4. Mbas këtij njoftimi, bazuar në ligjin për procedurat tatimore, bashkia do të njoftojë institucionet përkatëse me qëllim vendosjen e masës së sigurimit mbi pasurinë tuaj dhe të drejtave reale mbi to, me qëllim shlyerjen e plotë të detyrimit ndaj Bashkisë.

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA _____

Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë ____ . ____ . ____

NJOFTIM I PËRGJITHSHËM

PËR VENDOSJEN E BARRËS SIGURUESE DHE HIPOTEKORE

Nga Bashkia _____, Njoftim për publikun e interesuar

1. Mbështetur në nenin 90 e vijues të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Bashkia _____ ka vendosur masën e sigurisë barrë hipotekore mbi pasurinë e subjektit:

Subjekti: _____

NIPT: _____

Adresa: _____

2. Regjistrat tanë tregojnë se ju nuk keni paguar, në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoba	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

3. Subjektit të sipërcituar i është dërguar dokumenti “Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë”, por ky detyrim nuk është paguar ende. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës.

4. Ky dokument përfaqëson barrën siguroese dhe hipotekore në favor të Bashkia _____, mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat ipërkasin këtij subjekti, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara në afatin e kërkuar prej tij (detyrimi, gjoba dhe kamatëvonesë). Vendosja e kësaj barre hipotekore/siguroese synon të garantojë pagimin e tyre në rast të mospagimit vullnetar.

5. Ky dokument synon të njoftojë të gjitha palët që kanë interesa me këtë subjekt.



Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë

Aneks 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve

Nr. Prot. _____

Datë _____

Lënda: Urdhër sekuestrimi ekzekutiv

Drejtuar: Institucionit / Tjetër (psh punëdhënsi, nëse sekuestrohet paga) _____

Adresa: _____

Për dijeni: Tatimpaguesit (emër dhe mbiemër, NIPT/nr. identifikimi, selia/adresa)

1. Regjistrat tanë tregojnë se tatimpaguesi nuk ka paguar, në afatin e kërkuar ligjor, detyrimet si më poshtë:

Nr.	Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Gjoha	Interesa	Gjithësej
1.	Taksë ndërtese				
2.					
	Totali				

2. Tatimpaguesit i është dërguar Njoftim detyrimi dhe kërkesë për pagesë. Nr. ____, datë ____, por këto detyrime nuk janë paguar ende.
3. Këto detyrime tashmë janë subjekt i masave shtrënguese, në përputhje me legjislacionin tatimor. Mbështetur në nenin 90 e vijues, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve ka vendosur masën e sigurimit të detyrimit (specifiko _____), mbi pasuritë e tatimpaguesit: (specifiko _____).
4. Mbështetur në të dhënat mbi pasuritë e paluajtshme/të luajtshme, apo të ardhura të tjera që disponon (institucioni) _____, si më poshtë:

Nr.	Lloji i Pasurisë	Vendndodhja e pasurisë
1.		
2.		

Nr.	Lloji i të ardhurës	Vendndodhja
1.		



2.		

Në bazë të këtij Urdhëri, bazuar në ligjin për procedurat tatimore, Bashkia urdhëron sekuestron e pasurinë (specifiko _____), me qëllim shlyerjen e plotë të detyrimit ndaj Bashkisë.

5. Nëse keni kundërshtime, në lidhje me këtë titull ekzekutiv, mund të bëni ankesë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë të rrethit, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, konform gërmës d), neni 94 të ligjit "Për procedurat tatimore nr. 9920 datë 19.05.2008", i ndryshuar.

Drejtori i Taksave dhe Tatimeve

Kryetari i Bashkisë

